FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 95 — 7 gusht — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.42, datë 19.7.2012	Me objekt: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë...	5179
Vendim i GJK nr.43, datë 19.7.2012	Me objekt: Konstatimi i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).....	5184
Vendim i GJK nr. 44, datë 20.7.2012	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 119, datë 27.1.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	5189
Vendim i GJK nr.45, datë 23.7.2012	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.275, datë 21.11.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; i vendimit nr.290, datë 27.11.2007, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr.00-2009-383 (675), datë 26.11.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	5194

VENDIM
Nr. 42, datë 19.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datë 22.5.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 15 Akti që i përket:

KËRKUESE: Valbona Paluka

SUBJEKT I INTERESUAR: Zyra e Përmbarimit Tiranë në mungesë; Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, përfaqësuar nga Kristaq Profkola, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Nenet 6 dhe 41 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

Nenet 27 e 28, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza, kërkuesen që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Valbona Paluka ka qenë në marrëdhënie pune pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në detyrën e drejtores së përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Mbështetur në materialet e dosjes dhe në vendimet gjyqësore bashkëngjitur kërkesës rezulton se kërkueses, mbi bazën e aktit nr. l, datë 16.02.2010 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i është dhënë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil”*.

3. Mbi bazën e ankesës së kërkueses, Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 127, datë 25.11.2010, ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së kërkueses duke ndryshuar masën disiplinore nga “*largim nga shërbimi civil”* në masën disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, kthimin e kërkueses në pozicionin e mëparshëm të punës, si dhe pagimin e pagës për të gjithë kohën, duke filluar nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në zbatimin e këtij vendimi.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 23 datë 1.3.2011, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 127, datë 25.11.2011 të Komisionit të Shërbimit Civil.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në Dhomë Këshillimi), me vendimin nr. 00-2011-986, datë 23.6.2011, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ndaj vendimit nr. 23, datë 1.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 28 datë 24.3.2011, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 23, datë 1.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Zyra e Shërbimit Përmbarimor pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresë nr. 4386 datë 11.4.2011, ka lajmëruar Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ekzekutim vullnetar, ndërsa me shkresat nr. 6552, datë 13.6.2011 dhe nr. 8314, datë 28.7.2011 e ka lajmëruar atë për ekzekutim të detyruar. Po kështu, kjo zyrë, me shkresën nr. 8314, datë 28.7.2011, i është drejtuar po kësaj Ministrie me kërkesë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

8. Në përgjigje të këtyre shkresave Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me shkresën nr. 3923/1, datë 6.9.2011, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe Zyrës së Përmbarimit Tiranë, se bazuar në pikën 49 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 16.6.2011 *"Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike*" ai ka detyrimin ligjor të rishikimit të strukturës organizative të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe, në këto kushte, ekzekutimi i vendimit të kërkueses nuk mund të bëhet, ndërsa, për sa i përket detyrimit për pagimin e pagës, është i detyruar të zbatojë vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 2.7.2011"*Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore"*.

9. Kërkuesja, nëpërmjet një ankese ndaj përgjigjes së Sekretarit të Përgjithshëm, i është drejtuar Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për dijeni Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Kryetares së Kuvendit, Ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Departamentit të Administratës Publike.

10. Nga Zyra e Përmbarimit Tiranë është vazhduar ekzekutimi i detyrueshëm, duke kryer një sërë aktesh dhe veprimesh përmbarimore. Konkretisht, me shkresat nr. 9224 prot., datë 8.9.2011 dhe nr. l0335 prot., datë 30.9.2011, Zyra e Përmbarimit Tiranë i ka ripërsëritur kërkesën Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv; me shkresën nr. 13096 prot., datë 7.12.2011 ka urdhëruar Degën e Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative; me shkresën nr. 2645 prot., datë 16.3.2012 i ka kërkuar kësaj Ministrie që të bëjë ekzekutimin e menjëhershëm të titullit ekzekutiv duke informuar shkresërisht për masat që do të merrnin për ekzekutimin e titullit ekzekutiv; me shkresën nr. 3686 prot., datë 8.4.20l2 i ka kërkuar Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Degës së Thesarit Tiranë që të informonin për masat e marra prej tyre për ekzekutimin e vendimit të dhënë në favor të kërkueses.

11. Në përgjigje të këtyre shkresave Dega e Thesarit Tiranë, me shkresat nr. 3020 prot., datë 8.11.2011 dhe 3440/ 2, datë 18.1.2012, ka informuar Zyrën e Përmbarimit Tiranë se kjo degë, me urdhër të brendshëm, ka vendosur bllokimin e fondeve buxhetore në artikullin 602 të institucionit debitor, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me shkresën nr. 125 datë 6.3.2012, ka vënë në dijeni Degën e Thesarit Tiranë mbi grafikun e likuidimeve gjyqësore, duke u shprehur se mbështetur në shkresën nr. 10 355, datë 30.9.2011, të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, për kërkuesen do të likuidohet çdo muaj vlera 10.000 lekë, likuidim që ka filluar të ekzekutohet.

13. Kërkuesja, nëpërmjet kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pretendon cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, për arsye se:

a) Detyrimi që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë i dhënë në favor të saj për "*kthimin në pozicionin e punës si drejtore e përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*" në mënyrë të paarsyeshme dhe të pajustifikuar është vonuar dhe nuk është zbatuar prej subjektit të interesuar, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

VKM nr. 474, datë 16.6.2011 dhe VKM nr. 472, datë 2.7.2011 nuk përbënin pengesë për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor.

Funksioni i saj në administratën publike në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre akteve normative nënligjore nuk rezultonte i paplotësuar.

Kërkueses ende nuk i është ofruar nga subjekti i interesuar asnjë funksion tjetër administrativ në përputhje me strukturën e re të miratuar.

b) Vonesa e ekzekutimit të detyrimit "*të pagimit të pagës për të gjithë kohën, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në zbatimin e këtij vendimi"* prej subjektit të interesuar, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ka qenë arbitrare, e paarsyeshme dhe e pajustifikuar, pasi gjatë gjithë vitit financiar 2011, vit në të cilin ka lindur ky detyrim, fondi i pagës së funksionit të kërkueses ka qenë i planifikuar në buxhetin e Ministrisë dhe pagesa ka qenë e mundur të paguhej deri në fund të këtij viti, pasi ka pasur fond të mjaftueshëm për këtë pagesë.

Mënyra dhe masa e ekzekutimit të këtij detyrimi, e caktuar në mënyrë diskrecionale prej këtij subjekti, është jo proporcionale, e paarsyeshme dhe e pajustifikuar në raport me vetë masën e plotë të vlerës.

14. **Subjekti i interesuar** Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, kërkoi rrëzimin e kërkesës duke parashtruar këto prapësime:

a) Çdo vonesë eventuale në ekzekutimin e vendimit gjyqësor nuk ka ardhur si pasojë e pengesave të qëllimshme, të paarsyeshme dhe të pajustifikuara, por për shkak të rrethanave të veçanta objektive që nuk kanë dëmtuar thelbin e të drejtës së kërkueses, pasi vendimi gjyqësor është duke u ekzekutuar. Si rrjedhim, nuk jemi përpara cenimit të së drejtës themelore për një proces të rregull ligjor si pasojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

Pamundësia e përkohshme dhe ngadalësia e ekzekutimit ishin si pasojë e nxjerrjes dhe e zbatimit të VKM-së nr. 474, datë 16.6.2011 *"Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike*", VKM-së nr. 472, datë 2.7.2011 "*Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore", dhe* VKM-së nr. 355, datë 2.6.1998 "*Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit*".

Këto akte normative nënligjore vendosnin detyrimin mbi këtë subjekt të interesuar për të rishikuar menjëherë strukturën e brendshme të tij në bazë të përcaktimeve të reja.

Miratimi zyrtar i strukturës së këtij subjekti u bë me VKM-në nr. 32, datë 7.3.2012, për pasojë, në momentin e paraqitjes pranë Gjykatës Kushtetuese të kërkesës nga ana e kërkueses, ky subjekt ishte ende në procesin fillestar të zbatimit të kësaj strukture.

Gjithashtu, në kushtet kur në bazë të akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave struktura e brendshme e këtij subjekti është ndryshuar, dhe funksioni i kërkueses është suprimuar, pritej të vlerësohej përshtatshmëria e funksioneve të kryera prej kërkueses sipas strukturës së vjetër ku është bazuar vendimi gjyqësor, me funksionet aktuale të strukturave të reja të Ministrisë, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave gjatë mungesës së saj.

b) Procedura e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të dhënë në favor të kërkueses ka filluar gjatë vitin buxhetor 2011, vit në të cilin fondet nga buxheti i shtetit për llogari të këtij subjekti ishin përcaktuar për zëra dhe detyrime të lindura më parë.

Gjatë vitit 2011 ishte e pamundur të likuidoheshin detyrime të lindura në mënyrë të paparashikuar, pasi një gjë e tillë pengohej prej VKM-së nr. 472, datë 2.7.2011. Likuidimi i këtij detyrimi financiar është përfshirë në zërat buxhetorë përkatës, në llogari të këtij subjekti, të përcaktuar në buxhetin e vitit 2012, me anë të së cilës parashikohen likuidimet e detyrimeve të lindura nga proceset gjyqësore gjatë vitit 2011.

Subjekti i interesuar ka filluar likuidimin e detyrimit financiar që buron prej vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas grafikut të likuidimeve gjyqësore të përcaktuar në shkresën nr. 125, datë 6.3.2012 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit drejtuar Degës së Thesarit Tiranë.

Sa më sipër, në vlerësimin e këtij subjekti, afati kohor i nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor, parë në kompleksitetin e çështjes dhe të sjelljes së tij si autoritet publik, është proporcional, i arsyeshëm dhe i justifikuar dhe që nuk cenon thelbin e së drejtës së kërkueses.

II

Mbi cenimin e së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë

15. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë (Gjykata) rithekson se shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

16. Në praktikën e saj të vazhdueshme kjo Gjykatë ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke pranuar se: "… parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj … ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë".

17. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre" (*vendime nr. 43/2007; nr. 1/2009; nr. 6/2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor *(shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 6, datë 6.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese)*. Një vonesë në ekzekutim mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës *(shih vendimin nr. 43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim subjektet pjesëmarrëse në këtë gjykim kushtetues, edhe pse pranojnë faktin e vonesës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dhënë në favor të kërkueses, kanë kundërshti lidhur me efektet juridike që rrjedhin nga aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave. Për palën kërkuese, këto akte nuk përbënin pengesë për ekzekutimin e vendimit, përkundrazi, për subjektin e interesuar, vonesa eventuale e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor është kushtëzuar nga dalja dhe hyrja në fuqi e këtyre akteve.

19. Gjykata në lidhje me këtë çështje çmon të theksojë se, bazuar në nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë dhe se dispozitat e saj zbatohen drejtpërdrejt, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Gjithashtu, bazuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

20. Në vijim të këtyre referimeve, Gjykata vlerëson se prej parashikimeve dhe urdhërimeve të këtyre dispozitave kushtetuese rezulton se, detyrimi i organeve të shtetit për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, buron drejtpërdrejt jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe se dispozita kushtetuese (neni 142/3 i saj) në këtë aspekt është e vetëzbatueshme nga organet e shtetit.

21. Si rrjedhim, organet e shtetit nuk mund t'i shmangen përmbushjes së këtij detyrimi të drejtpërdrejtë kushtetues me pretendimin se ekzekutimi i vendimit gjyqësor është bërë i pamundur ose/dhe është vonuar thjesht dhe vetëm për shkak të akteve të tjerave normative që në hierarkinë e akteve, të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, vijnë pas Kushtetutës sepse një gjë e tillë do të çonte në cenimin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, të ndarjes dhe balancimit të pushtetit dhe të së drejtës kushtetuese për një gjykim të drejtë. Për pasojë, asnjë organ i administratës publike nuk mundet që duke ushtruar autoritetin e tij publik, qoftë edhe për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, të pengojë apo vonojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në një gjykim në të cilin ai ka qenë palë. Përkundrazi, këto organe, si çdo subjekt tjetër palë e një gjykimi, kanë të drejtë që të kundërshtojnë në gjykatë ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të mjeteve mbrojtëse të parashikuara nga legjislacioni kombëtar në fuqi, e drejtë kjo që në rastin konkret nuk rezulton që të jetë ushtruar prej subjektit të interesuar Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

22. Gjykata, bazuar në sa më sipër, arrin në konkluzionin se VKM-ja nr. 474, datë 16.06.2011 dhe VKM-ja nr. 472, datë 2.7.2011 nuk përbënin pengesë për ekzekutimin e detyrimit kryesor që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, i dhënë në favor të kërkueses për "*kthimin e saj në pozicionin e*

punës", sepse këto akte normative nënligjore janë nxjerrë pasi kishte lindur detyrimi kushtetues i këtij subjekti të interesuar për të ekzekutuar vendimin gjyqësor. Si rrjedhim, subjekti i interesuar, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nuk mund të përdorte autoritetin e tij publik, qoftë edhe për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, për të penguar apo vonuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të dhënë në një gjykim në të cilin ai kishte qenë palë. Për pasojë, funksioni i kërkueses në administratën publike, në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre akteve normative nënligjore, nuk mund dhe nuk duhej të konsiderohej i paplotësuar, dhe çdo vonesë në ekzekutimin e këtij urdhërimi të vendimit gjyqësor ka ardhur si pasojë e pengesave të paarsyeshme dhe të pajustifikuara të shkaktuara nga subjekti i interesuar, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

23. Gjithashtu, çdo pasojë që mund të lindte nga ristrukturimi eventual që mund të prekte funksionin e kërkueses, për shkak të zbatimit të këtyre akteve nënligjore, gjen rregullimin e saj në nenin 23 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i Nëpunësit Civil*" (i ndryshuar) dhe në VKM-në nr. 360, datë 14.7.2000 "*Për lirimin nga shërbimi civil*".

24. Përveç sa më sipër, Gjykata vëren se edhe pse afati për përshtatjen e strukturave organizative, sipas standardeve të përcaktuara në këtë akt nënligjor, ka përfunduar, kërkueses ende nuk i është ofruar nga subjekti i interesuar asnjë funksion tjetër administrativ në përputhje me strukturën e re të miratuar.

25. Po kështu, Gjykata, bazuar në faktin që rezultoi në gjykimin kushtetues se gjatë gjithë vitit financiar 2011, vit në të cilin ka lindur detyrimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor, fondi i pagës së funksionit të kërkueses ka qenë i planifikuar dhe i paprekur në buxhetin e Ministrisë, çmon se edhe çdo vonesë e ekzekutimit të detyrimit dytësor të pagimit të pagës në favor të kërkueses prej subjektit të interesuar, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ka qenë e paarsyeshme dhe e pajustifikuar.

26. Pavarësisht se ky detyrim ka filluar të ekzekutohet prej subjektit të interesuar, në vlerësimin e kësaj Gjykate mënyra dhe masa e ekzekutimit të këtij detyrimi për vitin 2012 e në vazhdim, i caktuar në mënyrë të njëanshme prej këtij organi të pushtetit publik, është jo proporcionale, e paarsyeshme dhe e pajustifikuar në raport me vetë masën e plotë të vlerës së detyrimit në favor të kërkueses, gjë e cila cenon në vetvete thelbin e kësaj të drejte.

27. Si përfundim, Gjykata sa më sipër konstaton se subjekti i interesuar Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet sjelljes së tij, ka cenuar të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 23, datë 1.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Admir Thanza, Fatmir Hoxha.

VENDIM
Nr. 43, datë 19.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datë 15.5.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 10 Akti, që i përket:

KËRKUES : Bardhyl Shehu

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar nga Adnand Kosova, me autorizim.

Zyra e Përmbarimit Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza, kërkuesin, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbështetur në vendimet gjyqësore bashkëngjitur kërkesës rezulton se, mbi bazën e urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 281, datë 29.10.2008, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme ka ushtruar kontroll në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në përfundim të kontrollit janë konstatuar shkelje në mosrespektimin e ligjit procedural penal në fazën e hetimit paraprak dhe në përfaqësimin e akuzës në gjyq nga ana e prokurorit Bardhyl Shehu (kërkuesi).

2. Prokurori i Përgjithshëm, pasi ka vlerësuar sugjerimet e Këshillit të Prokurorisë dhe shkeljet ligjore të kërkuesit si të rënda dhe të natyrës që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit, i ka propozuar Presidentit të Republikës shkarkimin nga detyra të tij.

3. Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 6228, datë 2.9.2009, ka dekretuar shkarkimin nga detyra të kërkuesit.

4. Për shfuqizimin e vendimit administrativ, dekretit nr. 6228 të sipërpërmendur, kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën e Apelit Tiranë e cila, me vendimin nr. 25, datë 18.3.2010 (referuar si vendimi nr. 25), vendosi “*Pranimin e padisë së paditësit Bardhyl Shehu. Kthimin në detyrën e mëparshme të paditësit si prokuror pranë prokurorisë së rrethit gjyqësor Kurbin. Detyrimin e palës së paditur, Prokuroria e Përgjithshme, t’i paguajë paditësit Bardhyl Shehu, pagën e gjashtë muajve.*”

5. Në datën 21.4.2010, kërkuesi i është drejtuar me shkrim Prokurorisë së Përgjithshme (subjekti i interesuar) për t'i kërkuar ekzekutimin e vendimit nr. 25. Me anë të shkresës nr. 1055/6 ex-09 Prot., datë 28.4.2010, subjekti i interesuar i është përgjigjur kërkuesit se nuk mund ta ekzekutonte vendimin nr. 25, pasi konsideronte se ai vendim nuk ishte i formës së prerë përderisa kundër tij ishte ushtruar rekurs pranë Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 3.12.2010, pasi shqyrtoi rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr. 00-2010-1271, vendosi mospranimin e tij pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

7. Në datën 1.3.2011, me vendimin nr. 24 të po kësaj date, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 25.

8. Në datën 30.3.2011 kërkuesi i është drejtuar me një shkresë Zyrës së Përmbarimit Tiranë me anë të së cilës kërkoi vënien në ekzekutim të vendimit nr. 25.

9. Zyra e Përmbarimit Tiranë, me shkresën nr. 4815 prot., datë 26.4.2011, ka lajmëruar subjektin e interesuar për ekzekutim vullnetar. Në mungesë të një përgjigjeje nga subjekti i interesuar, kjo Zyrë, me shkresën nr. 5175 prot., datë 4.5.2011, i njofton subjektit të interesuar vendimin për kalimin në ekzekutim të detyrueshëm.

10. Në datën 17.6.2011, me shkresën nr. 6792 prot., Zyra e Përmbarimit Tiranë i është drejtuar subjektit të interesuar duke kërkuar informacion në lidhje me veprimet e kryera prej tij për ekzekutimin e vendimit nr. 25.

11. Ndërkohë, për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2010-1271, datë 3.12.2010, subjekti i interesuar i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese Kolegji i së cilës, me vendimin nr. 68, datë 23.6.2011, vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Në datën 23.11.2011, me shkresën nr. 1569/5 prot., subjekti i interesuar ka informuar Zyrën e Përmbarimit Tiranë se ishte në pamundësi për të ekzekutuar vendimin nr. 25, pasi organika e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin është e plotësuar dhe buxheti i miratuar për vitin 2011 dhe vitin 2012 nuk ka asnjë fond për shpërblimin e punonjësve të cilët kanë fituar me vendim të formës së prerë të drejtën për t'u dëmshpërblyer.

13. Në datën 22.12.2011 Zyra e Përmbarimit Tiranë i ka komunikuar kërkuesit qëndrimin e mësipërm të subjektit të interesuar.

14. Në datën 30.3.2012, me shkresën nr. 1569/11 ex.11 prot., subjekti i interesuar informoi Gjykatën Kushtetuese se vazhdonte të ishte në pamundësi për të ekzekutuar vendimin nr. 25 për sa i takon detyrimit për kthimin e kërkuesit në detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë Kurbin. Ndërsa, për sa i takon detyrimit financiar që rrjedh nga ky vendim, subjekti i interesuar, me po këtë shkresë, i komunikon Gjykatës Kushtetuese urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 54, datë 23.03.2012, me anë të të cilit urdhërohet shlyerja me këste e një shume prej 510 000 lekësh në favor të kërkuesit.

II

Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

15. ***Kërkuesi*** pretendon se gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 25, datë 18.3.2010, i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor pasi, për shkak të refuzimit dhe pasivitetit të organeve kompetente, vendimi i formës së prerë, dhënë në favor të tij, nuk po ekzekutohet edhe pse kanë kaluar afërsisht dy vjet nga dhënia e tij.

16. ***Subjekti i Interesuar*** gjatë gjykimit parashtroi në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

16.1 Ankimet e prokurorëve për shkarkim nga detyra shqyrtohen direkt në Gjykatën e Apelit pa kaluar fillimisht nga gjykatat e shkallës së parë. Rrjedhimisht, vendimi nr. 25, datë 18.3.2010 i Gjykatës së Apelit Tiranë konsiderohet si një vendim i shkallës së parë i cili, në rast rekursi, ka fuqi detyruese vetëm pasi të shprehet Gjykata e Lartë.

16.2 Në përputhje me vendimin nr. 21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese, llogaritja e afatit të arsyeshëm duhet të fillojë jo në datën kur vendimi merr formë të prerë por në datën kur është lëshuar urdhri i ekzekutimit.

16.3 Në përputhje me vendimin nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese, llogaritja e afatit të arsyeshëm duhet të përcaktohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave dhe kompleksitetit të çështjes, sjelljes së palëve etj. … Në përputhje me këto kritere subjekti i interesuar, edhe pse ka qenë në pamundësi objektive për shkak të rrethanave dhe parashikimeve ligjore për të ekzekutuar vendimin nr. 25, ka treguar vullnet të plotë dhe ka bërë përpjekjet e duhura për të ekzekutuar atë vendim.

16.4 Subjekti i interesuar ka nisur të ekzekutojë detyrimet financiare që rrjedhin nga vendimi nr. 25 dhe do të shlyejë përfundimisht këto detyrime në muajin nëntor të vitit 2012.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm

17. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 25, datë 18.03.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas kërkuesit, që prej marrjes formë të prerë të këtij vendimi ka kaluar një kohë e gjatë e cila është e pajustifikuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

18. Ekzekutimi, brenda një afati të arsyeshëm, i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, tashmë ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Gjykata Kushtetuese ka rikonfirmuar në shumë vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009*).

21. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së aplikantit/kërkuesit, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, është theksuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

i)Periudha që duhet marrë në konsideratë

22. Gjykata Kushtetuese vlerëson se është i pabazuar prapësimi i subjektit të interesuar sipas së cilit detyrimi i këtij subjekti për të ekzekutuar vendimin nr. 25 ka lindur vetëm pasi është lëshuar urdhri i ekzekutimit të atij vendimi.

23. Gjykata Kushtetuese, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, vlerëson se organet shtetërore nuk duhet t'i kërkojnë personit ndaj të cilit janë debitorë që të iniciojë procedura të ekzekutimit të vendimit (*shih vendimin nr. 13, datë 21.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*. Organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm. Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar.

24. Në çështjen konkrete, nuk rezulton që ekzekutimi i vendimit nr. 25 të jetë pezulluar me vendim të Gjykatës së Lartë, për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky vendim është i ekzekutueshëm që në datën 18.3.2010 e cila është data e marrjes së tij.

25. Gjykata konstaton se, në momentin e vendimmarrjes së saj, vendimi nr. 25 ende nuk është ekzekutuar plotësisht dhe, për arsyet e mësipërme, vlerëson se periudha e cila duhet të merret në konsideratë është një periudhë e cila ka filluar në datën 18.03.2010 dhe që prej asaj date vazhdon në mënyrë të pandërprerë.

ii) Kompleksiteti i çështjes

26. Gjykata Kushtetuese vëren se çështja objekt gjykimi, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike apo ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji me këtë qëllim.

iii) Sjellja e kërkuesit

27. Gjykata Kushtetuese vëren se kërkuesi nuk ka kryer asnjë veprim që mund të ketë sjellë vonesa në ekzekutimin e vendimit nr. 25.

28. Mbështetur në aktet paraqitur nga palët rezulton se kërkuesi që në datën 21.4.2010 ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 25 dhe në po atë datë i ka kërkuar subjektit të interesuar ekzekutimin e këtij vendimi.

29. Kërkuesi ka vënë në ekzekutim urdhrin e ekzekutimit pasi është lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 1.3.2011.

30. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi për ekzekutimin e vendimit nr. 25 i është drejtuar në mënyrë të përsëritur disa institucioneve si Zyrës së Përmbarimit Tiranë, Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit dhe Presidentit të Republikës.

31. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se sjellja e kërkuesit nuk ka shkaktuar vonesa në ekzekutimin e vendimit nr. 25 dhe kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e të drejtës së cenuar.

iv) Sjellja e autoriteteve publike

32. Mbështetur në deklarimet e palëve gjatë gjykimit dhe aktet paraqitur prej tyre, rezulton se subjekti i interesuar pretendon se mund të ekzekutojë vetëm detyrimet financiare që i ngarkohen nga vendimi nr. 25 dhe vijon të mbetet në pamundësi për të ekzekutuar detyrimin për të rikthyer kërkuesin në punë.

33. Subjekti i interesuar administroi në gjykim urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 54, datë 23.03.2012. Mbështetur në këtë urdhër subjekti i interesuar është angazhuar të shlyejë tërësinë e detyrimit financiar brenda muajit nëntor të vitit 2012. Subjekti i interesuar paraqiti para Gjykatës gjithashtu "Urdhër-shpenzimin" nr. 90, datë 3.4.2012, me anë të të cilit vërtetohet që në llogarinë e kërkuesit është kaluar shuma prej 100800 lekësh. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se subjekti i interesuar po tregon vullnet për të ekzekutuar detyrimet financiare që burojnë nga vendimi nr. 25.

34. Megjithatë, Gjykata vëren që subjekti i interesuar vijon t'i përmbahet qëndrimit sipas të cilit ai është në pamundësi për të rikthyer kërkuesin në punë për shkak se organika e organit të Prokurorisë, siç është përcaktuar me ligj, është e plotësuar dhe nuk ka vende të lira.

35. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Mbështetur në aktet e paraqitura nga palët gjatë gjykimit rezulton se me propozim të subjektit të interesuar janë emëruar me dekrete të ndryshme të Presidentit të Republikës disa prokurorë që më parë ushtronin funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore ose të Drejtorit të Kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme. Më konkretisht, rezulton se me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7504, datë 4.6.2012, janë emëruar 10 prokurorë pranë prokurorive të rretheve të ndryshme. Rezulton se asnjë nga këto pozicione nuk i është ofruar kërkuesit.

37. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se subjekti i interesuar ka pasur mundësi për të ekzekutuar detyrimin ndaj kërkuesit duke e rikthyer në detyrë, qoftë pranë një prokurorie të një rrethit tjetër. Ai jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por nuk ka shfaqur deri tani vullnet për të bërë një veprim të tillë pasi vazhdon të shprehë hapur se ndodhet në pamundësi për të ekzekutuar këtë detyrim.

38. Si përfundim, Gjykata konstaton se Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet sjelljes së saj, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë vetëm në pjesën që parashikon rikthimin në detyrë të kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 25, datë 18.3.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë vetëm për sa i përket detyrimit për të rikthyer në detyrë kërkuesin.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Admir Thanza, Fatmir Hoxha.

VENDIM
Nr. 44, datë 20.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 17.1.2012 dhe 2.2.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 55/30 Akti, që i përket:

KËRKUES: Jorgo Qiqi, i përfaqësuar nga avokat Luan Hasanaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, në mungesë; Inspektorati Ndërtimor Urbanistik, Bashkia Tiranë i përfaqësuar nga Parid Sinella, me autorizim; Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, e përfaqësuar nga Kadri Skera.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 119, datë 27.1.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesin e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 251, datë 28.1.2002, ka vendosur pranimin e padisë së ngritur prej kërkuesit ndaj të padituri, degës se Policisë Ndërtimore Tiranë, dhe personit të tretë, Qendrës Spitalore Universitare, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, me objekt anulimin e aktit administrativ, vendimit nr. 16, datë 15.12.2001 të Degës së Policisë Ndërtimore Tiranë, me të cilin ishte vendosur prishja e një lokali të përdorur prej tij, ndodhur në territorin e Qendrës Spitalore Universitare Tiranë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 682, datë 11.6.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 251, datë 28.1.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Mbi rekursin e bërë nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 119, datë 27.1.2004, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 682, datë 11.6.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë, të vendimit nr. 251, datë 28.1.2002 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte konsumuar rrugën administrative.

Rezulton gjithashtu se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2732, datë 17.4.2007, mbi padinë e ngritur prej kërkuesit ndaj Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit/sot Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar dhe Degës së Policisë së Ndërtimit Tiranë/sot Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës, me objekt zhdëmtim dëmi dhe fitim të munguar si rezultat i shkatërrimit të pronës së ndodhur në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, detyrimin e Degës së Policisë së Ndërtimit Tiranë/sot Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë

Bashkisë së Tiranës për të dëmshpërblyer kërkuesin në shumën 9.828.000 lekë dhe pushimin e gjykimit ndaj Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit/sot Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 866, datë 08.04.2008.

Të dyja gjykatat, në marrjen e vendimeve të tyre respektive kanë bërë pjesë të shqyrtimit gjyqësor edhe ligjshmërinë e aktit administrativ/vendimit nr. 58, datë 19.3.2005 të Degës së Policisë së Ndërtimit Tiranë për prishjen e lokalit të kërkuesit, vendim ky i nxjerrë në bazë të procesverbalit të konstatimit nr. 24, datë 16.3.2005. Të dyja këto vendime gjyqësore jo vetëm e kanë vlerësuar si absolutisht të pavlefshëm vendimin nr. 58, datë 19.3.2005 të Degës së Policisë së Ndërtimit për prishjen e lokalit të kërkuesit por, edhe duke u bazuar vetëm në vendimet nr. 682, datë 11.6.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 251, datë 28.01.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që kanë shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të mëparshëm të Degës së Policisë të Ndërtimit nr. 16, datë 15.12.2001, e kanë konsideruar atë si cenim të gjësë së gjykuar.

Kërkuesi pretendon cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak se: gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa dijeninë dhe praninë e tij për shkak se rekursi i ushtruar nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" kundër vendimit nr. 682, datë 11.6.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk i është komunikuar, çka i ka mohuar kërkuesit të drejtën për të marrë pjesë, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në këtë shkallë gjykimi, pretendim të cilin e mbështet edhe në vendimin nr. 34, datë 3.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

Kërkuesi, bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 8577 datë 10.2.2000 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"* pretendon se legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkak se këtë shkelje e ka konstatuar më datën 21.12.2010 kur, për arsye të konfliktit tjetër gjyqësor që kishte për objekt gjykimi të njëjtën pronë të tij, atij i ishte kërkuar që të paraqiste si provë vendimin nr. 251, datë 28.1.2002 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, vendim të cilin ai e ka tërhequr në datën 21.12.2010 pranë arshivës së kësaj gjykate, nga ku është njoftuar edhe për ekzistencën e vendimit objekt kundërshtimi kushtetues.

Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, në bazë të nenit 39 të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", si kërkesë paraprake parashtroi pretendimin e moslegjitimimit si subjekt i interesuar në këtë gjykim kushtetues për shkak se bazuar në vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese, në ligjin nr. 9789 datë 16.7.2007 "Për Inspektoratin e Ndërtimit " të miratuar në zbatim të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese e që shfuqizoi ligjin nr. 8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", si dhe në nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi kushtetues i iniciuar nga kërkesa individuale e këtij kërkuesi duhet të vazhdojë vetëm ndaj Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, sepse të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i përkisnin Policisë së Ndërtimit i kanë kaluar këtij subjekti.

Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtroi këto prapësime:

- kërkuesi nuk legjitimohet për të bërë kërkesë para Gjykatës Kushtetuese sepse afati 2-vjeçar i paraqitjes së kërkesës së individëve, parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", është një afat prekluziv dhe si i tillë ndaj tij nuk lejohet mundësia e rivendosjes në afat;

- kërkuesi, edhe pse ka detyrimin që të provojë pretendimin e ngritur, nuk ka arritur ta provojë bindshëm atë pasi, bazuar në rregullat e rrepta procedurale mbi njoftimin e akteve, si dhe referuar faktit se çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore, rezulton e provuar se prej sekretarisë dhe trupës gjyqësore është bërë verifikimi i njoftimit të rekursit, dhe se rekursi i ushtruar prej palës tjetër i është komunikuar realisht atij.

II

Mbi legjitimitetin e subjektit të interesuar, Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës

Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, si kërkesë paraprake parashtroi pretendimin e moslegjitimimit si subjekti i interesuar në këtë gjykim kushtetues pasi, bazuar në ligjin nr. 9789, datë 16.7.2007 "Për Inspektoratin e Ndërtimit" të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i përkisnin Policisë së Ndërtimit i kanë kaluar Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar dhe për këtë arsye ky gjykim kushtetues, i iniciuar nga kjo kërkesë individuale, duhet të vazhdojë vetëm ndaj Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

Gjykata pasi u tërhoq, me vendim të ndërmjetëm vendosi rrëzimin e kësaj kërkese me arsyetimin se gjykimi kushtetues i kërkesave individuale ka një natyrë të ndryshme nga gjykimi i zakonshëm që zhvillohet prej gjykatave të pushtetit gjyqësor, sepse në fokusin e këtij gjykimi është vetëm respektimi i standardeve kushtetuese për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe jo zgjidhja e themelit të çështjes konkrete që shpall në mënyrë përfundimtare dhe detyruese të drejtat ose gjendjen e personave që patën qenë palë të procesit të gjykimit të zakonshëm. Në vijim të këtij qëndrimi, Gjykata çmoi se thirrja dhe pjesëmarrja e këtij subjekti të interesuar ka rëndësi për shqyrtimin e aspekteve të këtij gjykimi kushtetues. Megjithatë, ky subjekt, gjatë gjithë gjykimit, duke iu përmbajtur pretendimit të tij, zgjodhi që të mos përdorte rastin dhe mundësinë për t'u shprehur mbi aspektet formale dhe substanciale të kërkesës objekt gjykimi.

Mbi legjitimitetin e kërkuesit

Gjykata Kushtetuese, (Gjykata) thekson se legjitimimi "*ratione personae"* i individit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese sanksionohet nga neni 131 shkronja "f" dhe neni 134 shkronja "g" i Kushtetutës, ndërsa legjitimimi "*ratione temporis"* i këtij lloj kërkuesi parashikohet nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" i cili shprehet se "kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes". Në lidhje me këtë afat, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit ka parashtruar pretendimin se ai është një afat prekluziv dhe si i tillë ndaj tij nuk lejohet mundësia e rivendosjes në afat.

Gjykata për sa i përket këtij pretendimi konstaton se e drejta objektive në fuqi, si një prej llojeve të afatit njeh, pranon dhe rregullon edhe afatin prekluziv. Megjithatë, koncepti i afatit prekluziv nuk buron drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Po kështu, ky koncept nuk gjen pasqyrim dhe rregullim as në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Si rrjedhim, kuadri kushtetues dhe ligjor mbi bazën e të cilit është krijuar dhe funksionon Gjykata Kushtetuese, ku dhe zhvillohet gjykimi kushtetues në të cilin përfshihet edhe gjykimi i kërkesave individuale për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese, nuk mund të përbëjë referencë për të gjykuar mbi këtë aspekt të gjykimit kushtetues. Megjithatë, në nenin 1/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar se "*për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes*". Gjykata, referuar natyrës ligjore të çështjes, si dhe pretendimit të ngritur, çmon se dispozita ligjore që rregullon këtë aspekt procedural është neni 445 i Kodit të Procedurës Civile, dispozitë kjo që parashikon prekluzivitetin e ankimit sipas të cilit *"ankimi në Gjykatën e Apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe rishikimi nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve".*

Për rrjedhim, sa më sipër Gjykata çmon se ky pretendim i Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit duhet rrëzuar si i pabazuar.

Gjykata vlerëson se aspekti tjetër i rëndësishëm i legjitimitetit të individit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese është edhe *locus standi,* d.m.th. që në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, kërkesa të ketë lidhje me çështje që lidhen me interesat e tij. Gjykata në këtë këndvështrim vëren se gjykimi i zakonshëm, i kundërshtuar si proces i parregullt ligjor përpara Gjykatës Kushtetuese, ka pasur

për objekt paligjshmërinë e aktit/vendimit nr. 16, datë 15.12.2001 të Degës së Policisë së Ndërtimit Tiranë/sot Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës, për prishjen e lokalit të pretenduar nga kërkuesi si pronë e tij. Gjykata, referuar dosjes gjyqësore, konstaton se kërkuesit e drejta themelore e pronës nuk i është cenuar për shkak të këtij akti të organeve shtetërore sepse ky akt si pasojë e mosekzekutimit nuk i ka shteruar efektet juridike të tij dhe se gjykimi mbi të rezulton të jetë pushuar. Përkundrazi, kërkuesit, e drejta themelore e pronës rezulton t'i jetë cenuar si pasojë e nxjerrjes dhe e ekzekutimit të aktit/vendimit nr. 58, datë 19.3.2005 të Degës së Policisë së Ndërtimit Tiranë, i cili është nxjerrë në bazë të procesverbalit të konstatimit nr. 24, datë 16.03.2005, akt ky që rezulton gjithashtu të jetë edhe objekt i gjykimeve të tjera të papërfunduara që kërkuesi ka me këto institucione qendrore dhe vendore të administratës shtetërore, gjykime këto që akoma janë në proces.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk provon interesin për të kundërshtuar vendimin përkatës të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ai nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj
Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Petrit Plloçi, Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

Gjyqtarët në pakicë, në kundërshtim me vendimmarrjen e shumicës, çmojnë se kërkesa e kërkuesit Jorgo Qiqi me objekt "Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 119, datë 27.1.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë", jo vetëm që duhej të shqyrtohej në thelb prej Gjykatës Kushtetuese, por ajo edhe duhej pranuar si e bazuar në themelin e saj.

Pakica arrin në këtë konkluzion për shkak se gjatë gjykimit kushtetues kërkuesi arriti t'i tregojë Gjykatës Kushtetuese lidhjen e mjaftueshme të cenimit të së drejtës së tij kushtetuese prej aktit të kundërshtuar. Pakica vëren se objekti i gjykimit të zakonshëm, në të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi kushtetues, ka qenë paligjshmëria e veprimit të organeve shtetërore e cila, bazuar në nenin 44 të Kushtetutës, bëhet burim në vetvete i lindjes së një të drejte tjetër kushtetuese dhe konkretisht i të drejtës për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar në përputhje me ligjin. Për rrjedhim, e drejta kushtetuese për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar në përputhje me ligjin për të cilën kërkuesi ka kërkuar mbrojtjen juridike që garantohet prej nenit 42 të Kushtetutës, është një e drejtë që ka si parakusht logjik dhe juridik të saj paligjshmërinë e veprimit dhe mosveprimit të organeve shtetërore. Pakica vlerëson se pikërisht në këtë ndërvarësi logjike dhe juridike qëndron edhe interesi i kërkuesit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me anë të kërkesës objekt gjykimi. Kjo ndërvarësi logjike dhe juridike rezulton gjithashtu edhe nga vendimmarrja e gjykatave të pushtetit gjyqësor të cilat pranimin dhe njohjen e kësaj të drejte kushtetuese e kanë mbështetur edhe në vendimin nr. 251, datë 28.1.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 682, datë 11.6.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Për pasojë, prishja e këtyre dy vendimeve gjyqësore prej vendimit objekt kundërshtimi kushtetues i cili, sipas kërkuesit, është marrë në cenim të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, do të sjellë rrjedhimisht edhe

cenimin e së drejtës së tij kushtetuese për t'u zhdëmtuar në përputhje me ligjin, gjykimi i të cilës ende nuk ka përfunduar por ka kaluar tashmë për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë.

Gjyqtarët në pakicë çmojnë gjithashtu se edhe themeli i pretendimit të kërkuesit për cenim të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është i bazuar dhe duhej pranuar.

Nga verifikimi i dosjes gjyqësore rezulton se në rastin në shqyrtim mungonte akti i njoftimit të rekursit të ushtruar në gjykimin e zakonshëm nga kundërpala e kërkuesit dhe se gjykimi në Gjykatën e Lartë, në të cilën është dhënë vendimi objekt kundërshtimi, ishte bërë në mungesë të kërkuesit. Pjesëmarrësit e këtij gjykimi kushtetues, edhe pse nuk i kundërshtuan këto dy fakte me rëndësi kushtetuese, kishin kundërshti mbi rrjedhojat juridike që ato nxjerrin prej tyre, gjë që u pasqyrua edhe në kërkimet dhe prapësimet e tyre.

Kërkuesi pretendimin e tij e lidhi thjesht me faktin e mungesës në dosjen gjyqësore të aktit të njoftimit të rekursit dhe të zhvillimit të gjykimit në mungesë të tij. Përkundrazi, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, referuar rregullave procedurale të Kodit të Procedurës Civile mbi njoftimin e akteve, si dhe faktit se çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore, pretendoi se prej sekretarisë dhe trupës gjyqësore është bërë verifikimi i njoftimit të rekursit, dhe se rekursi i ushtruar prej palës tjetër i është komunikuar realisht kërkuesit.

Pakica, lidhur me këto pretendime dhe prapësime të parashtruara prej këtyre subjekteve, vëren se, bazuar në legjislacion procedural civil (nenet 119, 122 të KPC), akti i njoftimit të rekursit, si çdo akt procedural, ka si kusht të domosdoshëm për vlefshmërinë e tij, respektimin e rregullave dhe të formave të njoftimit, gjë që sjell dijeninë ligjore të aktit prej personit të cilit duhet t'i njoftohet akti. Po ashtu, bazuar në po këtë legjislacion (nenet 77-78, 130-144, 476, të KPC) respektimi i rregullave të njoftimit të rekursit, si njoftimi i çdo akti procedural, është detyrim ligjor i organeve gjyqësore në përbërjen dhe strukturën e të cilave përfshihet edhe sekretaria gjyqësore dhe nëpunësi gjyqësor, të cilët realizojnë dhe përmbushin edhe këtë detyrim ligjor. Nga ana tjetër, ky legjislacion nuk i njeh dhe nuk i ngarkon palës në gjykim asnjë barrë dhe detyrim në lidhje me respektimin e rregullave mbi këtë aspekt të veprimtarisë procedurale. Për rrjedhim, pakica çmon se barra e kësaj prove nuk mund të rëndojë mbi kërkuesin, por vetëm mbi organet gjyqësore të cilat kanë detyrimin të zhvillojnë një proces të rregullt ligjor duke i garantuar individit të drejtën për të marrë pjesë, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata edhe në vendimin e saj nr. 34, datë 3.10.2007 në të cilin është shprehur se "*e drejta për t'u mbrojtur, e cila realizohet nëpërmjet të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim, përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor. Realizimi i kësaj të drejte shtron para organeve gjyqësore detyrimin për të njoftuar palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, për të siguruar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar padrejtësisht nga gjykimi"*.

Pakica, bazuar në qëndrimin e mëparshëm të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 38, datë 20.9.2011, rithekson se referuar legjislacionit procedural civil, njoftimi i rekursit është një akt procedural, i cili, së bashku me listën e shqyrtimit të rekurseve, siguron njoftimin e palëve për të marrë pjesë në gjykim. Për rrjedhim, çdo e metë/pavlefshmëri, ose çdo mungesë e njoftimit të rekursit, cenon edhe të drejtën kushtetuese për të marrë pjesë, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në këtë shkallë gjykimi, çka e bën procesin jo të rregullt nga këndvështrimi kushtetues.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

VENDIM
Nr. 45, datë 23.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e "	"
Fatmir Hoxha	Anëtar	i "	"
Vladimir Kristo	Anëtar	i "	"

me sekretare Edmira Babaj, në datë 12.4.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 9 Akti, që i përket:

KËRKUES: Fatmir Zyka, përfaqësuar nga avokat Prel Martini, me deklaratë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 275, datë 21.11.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; i vendimit nr. 290, datë 27.11.2007, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr. 00-2009-383 (675), datë 26.11.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 22, 28, 31/a/c/d, 33/1, 42/1/2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është akuzuar për veprën penale të vrasjes me paramendim për gjakmarrje, të parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal (KP) dhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së. Gjatë fazës së hetimeve paraprake është kryer akti i ekspertimit psikiatro–ligjor nr. 27, datë 15.03.2005, i cili ka përcaktuar se kërkuesi nuk është i përgjegjshëm kundrejt ligjit për veprën penale të kryer.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, gjatë gjykimit, ka kryer një akt të ri ekspertimi psikiatro–ligjor nr.135, datë 02.11.2005, i cili ka përcaktuar se kërkuesi është i përgjegjshëm kundrejt ligjit për veprën penale të kryer, arsye për të cilën, me vendim nr.275, datë 21.11.2005**,** gjykata ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të vrasjes me paramendim për gjakmarrje, të parashikuar nga nenet 78/2, 50/ç/i dhe 17/2 të KP-së dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake të parashikuar nga nenet 278/2, 50/ç dhe 17/2 të KP-së. Në aplikim të nenit 55/1/2 të KP-së ka vendosur, përfundimisht, dënimin e tij me 24 vjet burgim.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendim të ndërmjetëm të datës 03.02.2006, ka pranuar fillimisht kërkesën për një akt ekspertimi të ri, por duke qenë se kërkuesi ka deklaruar se ai dhe familja e tij nuk janë në gjendje ekonomike të parapaguajnë ekspertët, me vendim të ndërmjetëm të datës 13.11.2007, bazuar në nenin 485/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka revokuar aktin e riekspertimit. Në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.174, datë 21.03.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për pjesën që ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e

veprës penale të vrasjes me paramendim, të parashikuar nga neni 78/2 i KP-së dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe ndryshimin e vendimit në pjesën e dhënies së një dënimi të vetëm, në zbatim të nenit 55 të KP-së, duke e dënuar atë me 22 vjet burgim.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr. 00-2009-383 (675), datë 26.11.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

II

5. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, pasi këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimet e mëposhtme:

5.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe ajo e Apelit Vlorë nuk kanë respektuar nenet 28/1 dhe 31/d të Kushtetutës pasi:

5.1.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka pranuar kërkesën e kërkuesit për riekspertim të ri, në një kohë kur dy ekspertimet e para kanë qenë diametralisht të kundërta.

5.1.2. Gjykata e Apelit Vlorë, në mënyrë të gabuar, e ka mbështetur vendimin për revokimin e riekspertimit të ri psikiatriko-ligjor në nenin 485 të KPP-së, pasi ky nen, në rast të parapagimit të shpenzimeve të procesit gjyqësor, u referohet palëve private dhe jo të pandehurit.

5.2. Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka respektuar nenet 22, 31/a dhe 33/1 të Kushtetutës, pasi në seancën e datës 23.10.2007, gjatë së cilës kanë bërë betimin dhe kanë marrë detyrën ekspertët, ka zhvilluar seancë gjyqësore në mungesë të kërkuesit dhe të avokates së tij, duke i caktuar kërkuesit mbrojtës kryesisht.

5.3. Gjykata e Lartë nuk ka respektuar nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, pasi ajo nuk ka zhvilluar një gjykim publik, por në Dhomë Këshillimi, duke i mohuar kështu kërkuesit të drejtën e një gjykimi publik dhe atë të ankimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e neneve 28/1 dhe 31/d të Kushtetutës

6. Gjykata thekson, paraprakisht, se ajo i vlerëson pretendimet e kërkuesit në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, vëren se pretendimet e kërkuesit, ndonëse u referohen neneve 28/1 dhe 31/d të Kushtetutës, si aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ato kanë të bëjnë në thelb me kërkesat e tij për kryerjen e një aktekspertimi të ri, gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe në apel, për shkak të përfundimeve diametralisht të kundërta të dy aktekspertimeve të para. Në këtë këndvështrim, kërkuesi nuk e vë në dyshim, në asnjë rast, kryerjen prej tij të veprës penale për të cilën akuzohet, por ai pretendon se është i papërgjegjshëm për veprën e kryer për shkak të gjendjes së tij psikike. Për këto arsye, Gjykata çmon të arsyeshme të analizojë, fillimisht, vlerën e aktit të ekspertimit dhe mënyrën e vlerësimit të tij në procesin gjyqësor, në drejtim të juridiksionit kushtetues.

7. Gjykata vëren se akti i ekspertimit është një provë shkencore që, edhe pse mbart në vetvete shumë avantazhe, për gjykatën do të mbetet një provë si të gjitha llojet e tjera të provave që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e çmojnë atë. Çmuarja e provës, pra dhe i asaj me ekspert, bëhet duke nxjerrë vlerën e saj provuese në koherencë me provat e tjera të procesit gjyqësor. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatat, të cilat nuk janë aspak të detyruara që të pranojnë *a priori* këto mendime, përveçse kur i bindin. Fakti se eksperti ofron mendime të specializuara për gjykatën në një fushë jojuridike, bën që mendimi i ekspertit të tërheqë vëmendje më të madhe në momentin e çmuarjes së tij nga ana e gjykatave të zakonshme dhe se këto të fundit duhet të argumentojnë me hollësi mendimin e kundërt. Nëse ato nuk pranojnë mendimin e ekspertit duhet të paraqesin argumente bindëse, por kjo nuk do të thotë se gjykatat duhet të pajtohen gjithmonë me konkluzionet e ekspertëve. Pra, gjykatat,

përfundimet e nxjerra nga ekspertët, i shqyrtojnë në kontekstin e të gjitha rrethanave të tjera të çështjes, duke analizuar, ndër të tjera, veprimet dhe sjelljet e të pandehurit (kërkuesit), sidomos kur bëhet fjalë për aktet e ekspertimit psikiatriko–ligjor.

8. Duke u nisur nga këto vlerësime, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit në lidhje me aktin e ekspertimit të ri, të kërkuar gjatë gjykimit në shkallë të parë, ka të bëjë në thelb me vlerësimin e provave dhe çmuarjen e tyre nga ana e gjykatës, pra me themelin e çështjes që ka pasur për gjykim kjo gjykatë. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr.22, datë 22.7.2009 dhe nr.14, datë 03.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

9. Gjykata, gjithashtu, vëren se ndonëse Gjykata e Apelit Vlorë, sikurse parashtron dhe kërkuesi, ka gabuar kur e ka mbështetur vendimin për revokimin e aktit të riekspertimit në nenin 485/1 të KPP-së, ajo, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ka analizuar dhe arsyetuar në vendim të gjitha rrethanat e çështjes, sjelljet e të pandehurit, provat e paraqitura nga palët dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura duke parashtruar në vendim argumentet për rrëzimin e tyre.

10. Në këtë këndvështrim, për sa u përket shkeljeve procedurale, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet në të gjitha shkallët e gjykimit, mund të konstatohen shkelje të ndryshme, por jo çdo shkelje e ligjit mund të cenojë parimet e procesit të rregullt ligjor në këndvështrimin kushtetues. Gjykata Kushtetuese, në praktikën e saj, ka pohuar se: "*Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, për të investuar Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e tyre sa herë shfaqet prezenca e shkeljes së normave procedurale*" dhe se "*ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj* (…). *Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë*" *(shih vendimet nr. 7, datë 28.02.2000; nr. 25, datë 28.10.2005; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenim të neneve 28/1 dhe 31/d të Kushtetutës, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e neneve 31/a dhe 33 të Kushtetutës

11. Kërkuesi ka parashtruar se i janë cenuar të drejtat e parashikuara nga nenet 31/a dhe 33 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka marrë masat që ai të jetë i pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore, duke zhvilluar seancën e datës 23.10.2007, gjatë së cilës kanë bërë betimin dhe kanë marrë detyrën ekspertët, në mungesë të kërkuesit dhe të avokates së tij, dhe, rrjedhimisht, i ka caktuar atij mbrojtës kryesisht. Në këtë mënyrë ai nuk ka arritur të shprehej nëse ishte dakord me ekspertët si dhe t'u bënte atyre pyetje.

12. Gjykata rithekson se, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkuesi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që kanë lidhje me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që individi të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara *(shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 36 datë 10.11.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga kërkuesi, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e

parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 6, datë 4.3.2010; nr.32, datë 28.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Nga rrethanat e çështjes konkrete Gjykata konstaton se kërkuesi, apo mbrojtësi i tij, nuk ka parashtruar pretendimin për cenim të neneve 31/a dhe 33 të Kushtetutës në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë.

15. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, për rrjedhojë, nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues lidhur me këtë pretendim.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës

16. Kërkuesi pretendon gjithashtu se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, në Dhomë Këshillimi, i ka mohuar atij të drejtën e një gjykimi publik dhe të drejtën e ankimit.

17. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se verifikimi nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, është atribut i Dhomës së Këshillimit dhe jo i seancës gjyqësore dhe se veprimtaria seleksionuese e Dhomës së Këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës apo të asaj për një gjykim publik, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (s*hih vendimet nr.4, datë 25.2.2009; nr.5, datë 26.1.2007; nr.8, datë 2.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i kësaj Gjykate ka vendosur mospranimin e rekursit për mungesë të shkaqeve të parashikuara nga ligji. Në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë e ligjit. E drejta e ankimit nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast. Si rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

19. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit, nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, pika "f" e 134, pika "g" të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me arsyetimin e shumicës, në lidhje me argumentet e saj për rrëzimin e kërkesës, për sa i takon pretendimit të kërkuesit për revokimin e vendimit për riekspertim nga ana e gjykatës së apelit, çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Shumica, në thelb, në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, ka vlerësuar se "*ndonëse Gjykata e Apelit Vlorë, sikurse parashtron dhe kërkuesi, ka gabuar kur e ka mbështetur vendimin për revokimin e aktit të riekspertimit në nenin 485/1 të KPP-së, ajo, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ka analizuar dhe arsyetuar në vendim të gjitha rrethanat e çështjes, sjelljet e të pandehurit, provat e paraqitura nga palët dhe i ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura duke parashtruar në vendim argumentet për rrëzimin e tyre*" (shih § 9 të vendimit).

3. Shumica, ka arritur në këtë përfundim pasi ka konstatuar se "*… për sa u përket shkeljeve procedurale, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet në të gjitha shkallët e gjykimit, mund të konstatohen shkelje të ndryshme, por jo çdo shkelje e ligjit mund të cenojë parimet e procesit të rregullt ligjor në këndvështrimin kushtetues"* (shih § 10 të vendimit).

4. Pakica e konsideron të rëndësishme të ritheksojë, sikurse vlerëson edhe shumica, se "*akti i ekspertimit është një provë shkencore që, edhe pse mbart në vetvete shumë avantazhe, për gjykatën do të mbetet një provë si të gjitha llojet e tjera të provave që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e çmojnë atë"* (shih § 7 të vendimit) dhe se "*çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave"* (shih § 8 të vendimit). Për këtë arsye, pakica mban të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me pretendimin e kërkuesit për kryerjen e një akti të ri ekspertimi gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë.

5. Ndërsa në lidhje me pretendimin e kërkuesit për revokimin e vendimit për riekspertim psikiatriko–ligjor gjatë shqyrtimit të çështjes në apel, pakica ndan një mendim të ndryshëm nga shumica, duke vlerësuar se ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe i mbështetur në standardet e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

6. Në rastin objekt shqyrtimi, pakica vëren se gjykata e apelit, në ushtrim të kompetencave të saj për çmuarjen dhe vlerësimin e provave të kërkuara nga palët, për shkak të ekzistencës së dy akteve ekspertimi diametralisht të kundërta, ka pranuar fillimisht kërkesën e të pandehurit për kryerjen e një akti ekspertimi të ri. Në një moment të dytë, duke qenë se kërkuesi ka deklaruar se ai dhe familja e tij nuk janë në gjendje ekonomike të parapaguajnë ekspertët, me vendim të ndërmjetëm të datës 13.11.2007, Gjykata e Apelit, bazuar në nenin 485/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka revokuar vendimin për riekspertim, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

7. Bazuar në parimin *jura novit curia*, Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pakica, pavarësisht nga formulimi i kërkesës, vëren se pretendimet e mësipërme të kërkuesit duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të mosdeklarimit fajtor dhe të mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe të parimit të barazisë së armëve, si elemente të rëndësishme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës.

8. Gjykata e ka analizuar gjerësisht në jurisprudencën e saj respektimin e standardit kushtetues të procesit të rregullt ligjor si në aspektin e provave të marra në mënyrë të paligjshme ashtu dhe në aspektin e barazisë së armëve.

9. Lidhur me parimin e mosdeklarimit fajtor dhe të mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të sanksionuar nga neni 32/2 i Kushtetutës, Gjykata në

jurisprudencën e saj të konsoliduar ka theksuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse procesi i realizuar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, i shqyrtuar si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Për këtë arsye, të gjitha provat duhet të paraqiten në prani të të akuzuarit, në një seancë publike me qëllim që të realizohet një proces kontradiktor *(shih vendimet nr.19, datë 12.6.2003 dhe nr. 19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Në këtë këndvështrim Gjykata ka vlerësuar, se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Synimi kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi *(shih vendimet nr. 19, datë 18.9.2008 dhe nr. 19, datë 12.6.2003 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po ashtu, lidhur me parimin e barazisë së armëve, Gjykata ka theksuar se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër *(shih vendimet nr. 19, datë 18.9.2008 dhe nr. 7, datë 27.4.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Duke iu kthyer çështjes konkrete, pakica çmon se revokimi i vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit nga gjykata e apelit, për shkak të pamundësisë ekonomike të kërkuesit për të parapaguar ekspertët, është bërë në shkelje të nenit 485/1 të KPP-së, pasi ky nen, në rast të parapagimit të shpenzimeve të procesit gjyqësor, u referohet palëve private dhe jo të pandehurit (fakt ky, sikurse u përmend më lart, i pakontestuar edhe nga shumica). Pakica vlerëson se gjykata vendos për marrjen e atyre provave që quan të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes pavarësisht nëse ato merren me kërkesë të palëve apo kryesisht. Për këtë arsye, akti i riekspertimit psikiatriko-ligjor, në momentin që është pranuar nga gjykata e apelit duhet të konsiderohet si provë kryesore në gjykim lidhur me përgjegjësinë penale të kërkuesit. Për pasojë, pakica çmon se revokimi i vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit, i bërë në kundërshtim me ligjin procedural, ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit si në lidhje me parimin e (mos) marrjes në mënyrë të ligjshme të provave ashtu edhe në aspektin e parimit të barazisë së armëve, pasi në këtë mënyrë e ka vënë kërkuesin në një pozitë më pak të favorshme se pala tjetër, prokuroria.

12. Duke shkuar më tej, pakica, gjithashtu, vëren se edhe Gjykata e Lartë nuk ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e Gjykatës së Apelit Vlorë në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë drejtim, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj *(shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006 dhe nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Si përfundim, pakica vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, në lidhje me revokimin e aktit të riekspertimit nga ana e Gjykatës së Apelit, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, kërkesa e tij, në këtë drejtim, duhej të ishte pranuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.8.2012
Doli nga shtypi më 7.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 28 lekë